

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Shtator, 2016*

SBASHK-u kremtoi Ditën Botërore të Mësuesve

U organizuan aktivitete të shumta dhe një Konferencë tematike



Këtë vit SBASHK-u ka shënuar në mënyrë të veçantë 5 tetorin- Ditën Botërore të Mësuesve. Kështu me 4 tetor në shumë shkolla të komunave të Kosovës janë shpërndarë posterë për 5 tetorin dhe veprimtarët tanë sindikalë kanë organizuar bashkëbiseda me nxënës e me kolegë duke shpjeguar rëndësinë e kësaj date për mësuesit kudo në ... (faqe 5)

Vizitë e suksesshme e delegacionit të SBASHK-ut në Gjermani

Përkrahje e madhe për SBASHK-un nga sindikata e arsimit gjerman GEW



Ka kohë që GIZ-i gjerman është duke zhvilluar një bashkëpunim korrekt e të frytshëm me SBASHK-un në shërbim të ... (faqe 7)

Delegacioni i SBASHK-ut u takua me Rektorin e Universitetit “Isa Boletini”

Gatishmëri e përbashkët për bashkëpunim

SBASHK-u në kuadër të aktiviteteve të përditshme po vazhdon me vizitat nëpër komnatat e Kosovës. Delegacioni i ... (faqe 11)

Intervistë me drejtorin e shkollës “Skënderbeu” dhe sindikalistin z.Fidan Shaqiri

Sinqeriteti, korrektësia dhe përkushtimi në shërbim të arsimit

Fidan Shaqiri ishte mësimdhënës dhe kryetar i sindikatës në shkollën “Skënderbeu” ... (faqe 3)

Edhe një takim i SBASHK-ut me Ministrin Kujtim Shala

Angazhim i përbashkët për realizimin e kërkesave të mësimdhënësve



Ministri në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala vazhdimisht ka bërë angazhime ... (faqe 10)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Detyra e mësuesit më shumë se profesion është mision human



SBASHK -u duke angazhuar aktivitete nëpër komuna dhe duke organizuar një Konferencë të suksesshme iu bashkua 32 milionë kolegëve nga e tërë bota në kremtimin e 5 tetorit- Ditës Botërore të Mësuesve. Mesazh i qartë doli nga këto aktivitete se duhet çmuar mësuesit sepse kështu përmirësojmë statusin e tyre dhe i ndihmojmë ata që ta kryejnë me sukses detyrën e tyre prej mësimdhënësi e edukatori. Angazhimi i Internacionales së Arsimit që në Konferencat e organizuara këtë vit për nder të 5 tetorit temë kyçe të jetë angazhimi për ta çmuar mësuesin dhe për ta respektuar angazhimin e tij në shërbim të arsimit dhe edukimit të brezave është i arsyeshëm sepse kudo në botë ka përpjekje që të lëndohet në atë apo këtë mënyrë personaliteti i mësuesit.

Edhe në Kosovë ka tendenca të tilla. Këto përpjekje duken se nuk janë të qëllimta, por nga ngutja e fjalës së pa menduar mirë apo të veprimt në moment nervoze lëndohet personaliteti i mësuesit. Prindërit tanë dikur nuk ishin të shkolluar sepse nuk kanë pasur mundësi, por shkollën dhe

mësuesin e kanë çmuar shumë. Mësuesi u bë figurë e dashur edhe në këngët popullore. Mësuesi ishte personalitet i respektuar dhe i mbrojtur. Të gjithëve na kujtohet se ne nxënësit e asaj kohe kur ankoheshim ndonjë herë për mësuesin se na ka qortuar, prindi nuk na lejonte të zgjatnim me llafe, por na qortonte e besa edhe na ndëshkonte duke na e prerë muhabetin se mësuesi është njeri i mirë dhe se ai e ka për të mirën e nxënësve. Tani disa nga prindërit modern ka raste kur në ankesat e fëmijëve të tyre e ngritin zërin kundër mësuesit para fëmijës së tyre dhe kështu e trimërojnë atë që të jetë i padëgjueshëm dhe që të mos i bëjë detyrat edhe të mos mësoj se e mbron “dashuria” e madhe e babait modern.

Të gjithë duhet të kuptojmë se detyra e mësuesit më shumë se profesion është mision human. Duke e ruajtur personalitetin e mësuesit i ndihmojmë atij ta kryej me përkushtim misionin e tij në luftë kundër errësirës e padijes e në shërbim të diturisë dhe dritës. Mos të harrojmë mësuesi ynë nuk u zmbraps nga misioni i tij as në vitet e vrara të Kosovës kur ndaj tij dhe shkollës shqipe u ushtrua dhunë dhe presion i pa parë .

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me drejtorin e shkollës “Skënderbeu” dhe sindikalistin z.Fidan Shaqiri

Sinqeriteti, korrektësia dhe përkushtimi në shërbim të arsimit



Fidan Shaqiri ishte mësimdhënës dhe kryetar i sindikatës në shkollën “Skënderbeu” në fshatin e tij të lindjes në Përlepnice. Tani me sukses kryen detyrën e drejtorit po në këtë vatër të njohur arsimore. Është edhe

veprimtar i dalluar i SBASHK-ut . Sinqeriteti, korrektësia dhe përkushtimi në shërbim të arsimit kanë bërë që ai të gëzojë respekt mes mësimdhënësve, sindikalistëve , por edhe te qytetarët. Nëse ndonjëherë ka pak kohë të lirë e gjejmë në terrenet sportive sepse pasion e ka futbollin. E falënderojmë për kohën që ka gjetur për intervistën në këtë numër të gazetës sonë “Arsimimi sot”

Arsimimi sot:

Kush është Fidan Shaqiri?

Fidani:

Jam i lindur në Përlepnice të Komunës së Gjilanit në vitin 1983. Shkollimin fillor e kam të kryer në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Gjimnazin “Zenel Hajdini” në Gjilan. Po ashtu, edhe Fakultetin e Edukimit të përfunduar në Gjilan në vitin 2006, ndërsa në vitin 2010 kam përfunduar Studimet Master në Drejtimin “Menaxhim në Arsim”, në Universitetin e Prishtinës.

Që nga viti 2007 kam filluar punën mësimdhënëse i shkollimit fillor në SHFMU “Skënderbeu” në Përlepnice, ndërsa nga 13 tetori i vitit 2014 jam drejtor i kësaj shkolle.

Pos punës së rregullt në arsim, pasioni im është futboli.

Arsimimi sot:

Cili është roli i drejtorit në shkollë në shërbim të arritjeve sa më të mëdha?

Fidani:

Shkolla është institucion që rreth vetes grumbullon staf profesional dhe administrativ me qëllim të krijimit të kushteve të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Drejtori i shkollës në këtë rast ka rol menaxhues dhe mbi të bie përgjegjësia e organizimit të punës dhe çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me drejtimin e shkollës.

Për të qenë një shkollë e mirë, drejtuesi i saj me doemos duhet të ketë vizion të qartë për zhvillimin e shkollës që menaxhon, i hapur për bashkëpunim me gjithë aktet që e përbëjnë institucionin brenda dhe jashtë saj, si dhe i aftë në menaxhimin e situatave të ndryshme, pra me një fjalë, roli i drejtorit është i rëndësishëm në arritjen e qëllimit të përgjithshëm që ka edukimi dhe arsimimi i brezave të rinj.

Arsimimi sot:

Si e shihni angazhimin sindikal në shkollën tuaj?

Fidani:

Është e drejtë e punëtorëve të kenë organizimin e tyre sindikal për të realizuar kërkesat e tyre, dhe ne jemi të vetëdijshëm se qëllimi I tyre nuk është vetëm plotësimit i kushteve për punë për vete, por edhe të krijojnë një klimë të përshtatshme për nxënës dhe kushte të favorshme për mësimnxënie.

Në shkollën tonë mbizotëron një frymë bashkëpunimi i ndërtuar mbi bazën e besimit dhe mirëkuptimit, sepse të dy palët kemi qëllim të mirë dhe fisnik për ta shndërruar shkollën vend të dashur për nxënës dhe kushte të mira pune. Duke u bazuar në dokumentet zyrtare të shkollës tonë, thuajse 100% e punëtorëve tanë, duke përfshirë edhe veten time këtu, janë anëtarë të SBASHK-ut, fakt i cili tregon se organizimi sindikal është i domosdoshëm për një funksionalizim sa më të fuqishëm të institucioneve edukativo-arsimore.

Bashkëpunimin tonë e kemi dhe me nivelin Komunal, ku kemi fatin që Sindikatën e Gjilanit ta udhëheqë një person shumë i përgjegjshëm dhe bashkëpunues (Blerim Mehmeti), i cili tregon

gatishmëri të lartë për krijim të raporteve të shëndosha pa dallime.

Arsimimi sot:

Ishit pjesë e delegacionit të SBASHK-ut në vizitën studimore në Gjermani. Përshtypjet tuaja nga këndi i një drejtori shkolle

Fidani:

Kisha fatin të jem pjesë e delegacionit të SBASHK-ut në vizitën e realizuar nëpër institucione të ndryshme arsimore në Gjermani me qëllim të përfitimit të përvojave të reja në fushë e arsimit, gjë që falënderoj SBASHK-un, GIZ-in dhe Sindikatën e Arsimit në Gjermani që ma mundësuan të pajisem më shumë njohuri të reja dhe të çmueshme.

Sistemi ynë arsimor nuk është në nivelin e duhur, pra ashtu siç dëshirojmë ta kemi dhe duhet një angazhim i përgjithshëm për të ndryshuar gjendjen në të mirë të brezave të rinj, të cilët meritojnë shumë më shumë dhe duke u nisur nga kjo, fal kësaj vizite kam arritur të kem një pasqyrë dhe vizion më të qartë se si duhet zhvillohet shkollla.

Arsimimi sot:

Kur flisni me të tjerët për këtë vizitë, çka veçoni?

Fidani:

Ka shumë të flitet e të shkruhet për dallimet e institucioneve tona arsimore dhe ato gjermane, por gjatë bisedave me të tjerët rreth kësaj vizite së pari veçoj qasjen e vet shtetit ndaj arsimit përmes investimeve që ka bërë dhe funksionalizimin e mekanizmave në shërbim të sistemit arsimor, pastaj jam i befasuar tejmasë me mënyrën e menaxhimit të shkollave, pra një qasje tejet demokratike dhe bashkëpunuese, një vetëdije e lartë e mësimdhënësve dhe punëtorëve tjerë të shkollave duke qenë secili në krye të detyrës ashtu siç ka për obligim, por ishte mese e qartë se shteti gjerman ka bërë investim të madh në krijimin e kushteve të punës duke pajisur në maksimum shkollat me gjitha mjetet e nevojshme, gjë që edhe mësimdhënësit tanë dhe nxënësit po të kishin kushte të tilla do kishte rezultate më të mira dhe do kishte llogaridhënie më e madhe, pra pa investim nuk mund të presim përmirësim të gjendjes në arsim në hapat që planifikojmë.

Arsimimi sot:

Çmoheni si drejtor i suksesshëm, si e arrini këtë?

Fidani:

Për të qenë real, nuk është e lehtë të kemi një vlerësim për performancën e shkollës dhe punës time apo kolegëve të mi derisa të mos kemi mekanizëm të qartë vlerësimi, por sido që të jetë faleminderit për këto fjalë.

Unë dua të cekim se si iu kam qasur punës së drejtorit të shkollës, duke pasur parasysh se edhe drejtimin në studimet Master e kam për udhëheqje arsimore, duke më ndihmuar tejmasë të kem një vizion më të qartë dhe rrugët që kam zgjedhur të përdori në arritjen e qëllimit dhe objektivave të zhvillimit të shkollës më kanë ndihmuar në punën e përditshme.

Për mua parësore është krijimi i raporteve të shëndosha me punëtorët përmes bashkëpunimit të ndërsjellët dhe zgjidhjen e çështjeve të ndryshme përmes komunikimit në me vete dhe çelësi i suksesit sipas meje është bashkëpunimi. Qasja ime që nga dita e parë ka qenë të punohet më shumë në ngritjen e cilësisë se sa në çështjet teknike me të cilat mund të merret edhe stafi tjetër i shkollës, duke planifikuar dhe shpenzuar edhe buxhetin e shkollës dhe ndihmën e donatorëve të ndryshëm në përmirësimin e kushteve që ndikojnë drejtpërdrejtë dhe tërthortë në ngritjen e cilësisë, por edhe ngritjen e përgjegjësisë të mësimdhënësit, duke besuar pastaj në punën e tyre.

Në vazhdimësi jam në shërbim të mësimdhënësve në çdo aspekt sa i përket punës, sepse që në ditët e para jemi dakorduar që zhvillimin e shkollës do ta bëjmë bashkërisht.

Arsimimi sot:

A keni ndonjë këshillë apo porosi për SBASHK-un?

Fidani:

Për një periudhë kohore kam pasur fatin të jem kryetar i sindikatës në nivel shkolle, duke arritur të përfitoj shumë përvojë pozitive e cila tani po më ndihmon tej mase në punë time në raport me të tjerët, sepse sindikata në vazhdimësi ka promovuar bashkëpunimin dhe ngritjen e përgjegjësisë. Po e përmendi këtë fakt për të treguar rolin e SBASHK-ut jo vetëm në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, por edhe në ngritjen e cilësisë në arsim.

Porosia ime do ishte që të vazhdohet me këtë vullnet pune për të përmirësuar edhe më tutje mirëqenien e punëtorëve, sepse fal insistimit të SBASHK-ut tani punëtorët arsimor gëzojnë respekt më të madh në shoqëri.

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar?

Fidani:

Nuk kam më shumë të shtoj, pos që t'iu përgëzoj për punën që po bëni për krijimin e kushteve sa më të mira pune për punëtorët arsimor si dhe për tërë sistemin e arsimit.

Gjatë muajit

SBASHK-u kremtoi Ditën Botërore të Mësuesve

U organizuan aktivitete të shumta dhe një Konferencë tematike

Këtë vit SBASHK-u ka shënuar në mënyrë të veçantë 5 tetorin- Ditën Botërore të Mësuesve. Kështu me 4 tetor në shumë shkolla të komunave të Kosovës janë shpërndarë posterë për 5 tetorin dhe veprimtarët tanë sindikalë kanë organizuar bashkëbiseda me nxënës e me kolegë duke shpjeguar rëndësinë e kësaj date për mësuesit kudo në botë.



Në nivel qendror është organizuar pikërisht më 5 tetor një Konferencë e suksesshme me temën kyçe: “Duke çuar mësuesit, përmirësojmë statusin e tyre. Kjo ngjarje ka shënuar edhe 50 vjetorin e Rekomandimeve të Organizatës Botërore të Punës (ILO) dhe UNESCO-s lidhur me statutin e mësuesit.

Krahas shumë mësimdhënësve e veprimtarëve të SBASHK-ut në këtë Konferencë ishin edhe Ministri i Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, Prof. Dr. Arsim Bajrami me anëtarë të kabinetit të tij, pastaj kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim z.Nait Hasani, rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit z.Ramë Vataj, kryetari i BSPK-së z.Haxhi Arifi, drejtoresha e Arsimit të Prishtinës znj.Arbërie Nagavci, kryetari i Këshillit të Prindërve të Kosovës z.Bajram Beqiri, personalitete të tjera publike dhe mësimdhënës veprimtar të SBASHK-ut nga e tërë Kosova.



Në fillim të fjalës së tij kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka kujtuar historikun e 5 tetorit duke përmendur Rekomandimet për statusin e mësuesit nga ILO/UNESCO për të vazhduar me betimin solemn të mësuesit. Ai ka kujtuar se mësuesit në Kosovë i bashkohen kolegëve të tyre kudo në botë në këtë festë të madhe të tyre, por kremtojnë me respekt edhe ditën e madh të mësuesit dhe shkollës shqipe - 7 Marsin.



Në vazhdim Jasharaj ka shpalosur fragmente nga historiku 26 vjeçar i SBASHK-ut. Ai gjithë arritjet i ka vlerësuar si rezultat të unitetit e qëndresës së mësimdhënësve dhe të ndihmës së madhe të sekretarit të përgjithshëm të EI-së z.Fred van Leeuwen dhe miqve tjerë ndërkombëtar. Kryetari i SBASHK-ut në duke përmbyllur paraqitjen e tij i është drejtuar pjesëmarrësve që të përkrahin idenë e SBASHK-ut që t'i drejtohen mikut të madh Fred van Leeuwen dhe organeve drejtuese të EI-së që të lobohet në të gjitha shtetet për pranimin e Kosovës në UNESCO. Ky propozim është përkrahur me duartrokitje të gjata nga gjithë pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësit e Konferencës i ka përshëndetur pastaj Ministri i MASHT-it, Dr. Prof. Arsim Bajrami. Ai ka përcjellë urimin në emër të gjithë Qeverisë së Kosovës për mësuesit dhe këtë konferencë e ka vlerësuar si ngjarje të madhe e pastaj ka vlerësuar lartë edhe kontributin e SBASHK-ut në vitet më të vështira për Kosovën. Ministri para pjesëmarrësve është shprehur se është duke u punuar me të madhe për finalizimin e Ligjit për statusin e mësimdhënësve për vitet e '90ta.



Është dashur mund e sakrificë për të ardhur deri në ditët e sotme”, ka thënë në fillim të fjalës së tij përshëndetëse Kryetari i Grupit Parlamentar për arsim z. Nait Hasani për të lavdëruar pastaj angazhimet nëpër vite e dekada të mësimdhënësve. Hasani ka apeluar te mësimdhënësit e që të vazhdojnë së punuari



E kanë përshëndetur Konferencën dhe kanë lavdëruar angazhimet e arritjet e SBASHK-ut edhe kryetari i Këshillit të Prindërve z.Beqiri, ai i BSPK-së z.Arifi, rektori i UPZ z.Vataj dhe drejtoresha e DKA-



Në kuadër të punimeve të Konferencës janë dhënë rekomandime që t'i dërgohet një shkresë Qeverisë së Kosovës duke kërkuar respektimin e Rekomandimeve të ILO/UNESCO që kanë të bëjnë me statusin e mësuesit dhe që një letër ti dërgohet edhe sekretarit të përgjithshëm të EI-së dhe organeve të larta atje, për ta



Pas pjesës solemne të Konferencës është vazhduar me pjesën tematike.

Në prezantimin e tij „Kryetari i parë i SBASHK-ut prof. dr. Agim Hyseni, ka kujtuar veprimtarët e asaj kohe dhe është shprehur se nga më të merituarit për krijimin e shtetësisë së Kosovës janë mësuesit e organizuar në SBASHK. Ai ka shpalosur momente kyçe të historikut të SBASHK-ut, duke përmendur edhe vitin 1993, ku miqtë ndërkombëtar, në krye me sekretarin e përgjithshëm të EI-së z. Fred van Leeuwen ia mundësuan pjesëmarrjen dhe prezantimin e situatës së asaj kohe të arsimit në Kosovë në Asamblenë e Përgjithshme të UNESCO-së.



Në pjesën tematike të konferencës, njohësi i mirë i historikut të arsimit shqip z. Bajram Shatri, ka folur me fjalë të zgjedhura për personalitetin dhe figurën e mësuesit duke shpalosur fakte nëpër vite e dekada. Ai ka vlerësuar se mësuesit në vitet më të vështira të okupimit të Kosovës, me sakrificë sublimë e duke u kthyer në një digë të pamposhtur ndaj sulmeve të

pushtetit serb, e mbajtën të gjallë arsimin shqip të Kosovës.



Është përcjellë me interesim të veçantë prezantimi i prof. Agim Hasani, shef i Arsimit në komunën e Bujanovcit. Ai ka treguar për sfidat e mëdha dhe problemet e shumta të arsimit shqip në tri komunat shqiptare atje.



Konferenca është përcjellë me vëmendje nga mediet e shkruara dhe elektronike dhe pjesëmarrësit e kanë vlerësuar si të suksesshëm këtë aktivitet të SBASHK-ut.

Vizitë e suksesshme e delegacionit të SBASHK-ut në Gjermani

Përkrahje e madhe për SBASHK-un nga sindikata e arsimit gjerman GEW



Ka kohë që GIZ-i gjerman është duke zhvilluar një bashkëpunim korrekt e të frytshëm me SBASHK-un në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim. Në shenjë respekti për angazhimin e

suksesshëm të SBASHK-ut GIZ ka mbuluar materialisht vizitën studimore të një delegacioni gjashtë anëtarësh të SBASHK-ut në dy lande të Gjermanisë. Në kuadër të këtij aktiviteti studimor janë vizituar shumë institucione arsimore dhe janë zhvilluar takime me rëndësi me përfaqësues të lartë të Sindikatës gjermane të arsimit GEW.



Një moment i veçantë i kësaj vizite ishin dy takime me kryetaren e sindikatës gjermane të arsimit në nivel të tërë Gjermanisë, znj. Marlis Tepe. "Ju përgëzoj për angazhimet dhe për arritjet. Këtu jeni si në shtëpinë tuaj dhe keni gëzuar e do të gëzoni mbështetjen e përkrahjen tonë të plotë në përpjekjet tuaja për të realizuar në tërësi kërkesat legjitime të anëtarësisë suaj", është shprehur znj. Tepe në takimin me delegacionin e SBASHK-ut.



"Zonjes Dagmar në GIZ gjatë takimeve në Prishtinë i kam thënë se duke mbështetur vizitën e delegacionit të SBASHK-ut në Gjermani po krijon dy mundësi të mrekullueshme për sindikatën e arsimit të Kosovës. Po mundëson që nga afër ky delegacion ta falënderojë sindikatën gjermane të arsimit GEW për përkrahjen morale e materiale që i ka bërë arsimit shqip të Kosovës gjatë kohës së okupimit, por edhe në vitet e para të pasluftës për mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e arsimit në Kosovës dhe po mundëson edhe të shihen nga afër aktivitetet dhe angazhimet që po bën sindikata në mbrojtjen e të drejtave të mësimdhënësve të Gjermanisë dhe për arritje sa më të mëdha në shërbim të arsimit." Është shprehur në takimin me kryetaren e GEW, kryetari SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj.



"Në agjendë ishte planifikuar vetëm një takim imi me ju, por po takohem për të dytën herë në shenjë respekti e për të dëshmuar edhe një herë përkrahjen tonë të plotë për sindikatën tuaj dhe për angazhimet që keni bërë e do të bëni në shërbim të mësimdhënësve të arsimit në shtetin tuaj", është shprehur kryetarja e GEW-së për të premtuar se në momentin e parë të mundshëm do ta vizitojë Kosovën dhe do të shoh nga afër angazhimet e sindikatës së arsimit dhe për të dëshmuar përkrahjen e plotë për SBASHK-un.



Pos këtyre takimeve delegacioni i SBASHK-ut, i shoqëruar nga përfaqësuesja e GIZ, znj. Lindita Ukimeraj dhe përfaqësuesi i sindikatës gjermane të arsimit, Jurgen FisCher kanë vizituar njërën nga shkollat e qytetit Jena. Delegacioni është mahnitur me mikpritjen dhe me ambientet, kushtet dhe me angazhimin e personelit të kësaj shkolle. Ky delegacion ka sjellë këtu përvojat e veta dhe ka marrë shumë përvoja e ide nga bashkëbiseda me drejtorin dhe stafin e këtij institucioni arsimor. Pas kësaj është vazhduar me vizitën në ambientet e një institucioni që përgatit kuadro për profesionet më të kërkuara në tregun e punës.



Në vazhdim të vizitës delegacioni i SBASHK-ut ka vizituar selinë e GEW në landin Tyingen dhe është takuar me kryetaren e sindikatës të arsimit për këtë land Katrin Vitsum. Ajo është shprehur e lumtur për këtë vizitë e pastaj i është përgjigjur shumë pyetjeve duke u dhënë mundësinë edhe mysafirëve që të tregojnë përvojat e tyre sindikale. Në shenjë respekti për delegacionin e SBASHK-ut mikpritësi ka organizuar edhe një takim në ambientet e Parlamentit të landit Tyingen. Ata janë pritur nga përgjegjësi për çështje arsimore në këtë Parlament, z. Torsten Wolf. Torsten është lavdëruar se arritjet në arsim këtu janë nga më të lartat në tërë Gjermaninë. Ai ka njoftuar mysafirët për angazhimet që bëhen nga komisionet dhe deputetet e pozitës dhe opozitës lidhur me arsimin në këtë pjesë të Gjermanisë.

Pas takimeve të shumta në këtë pjesë të Gjermanisë delegacioni i SBASHK-ut me plot përshtypje e ide të mira ka vazhduar këtë vizitë studimore në Frankfurt. Fillimisht ata kanë qëndruar në selinë qendrore të GEW-it dhe para kolegëve sindikalistë gjerman kanë prezantuar tri tema lidhur me sindikalizmin dhe arsimin e Kosovës.



Përshtypje të veçanta delegacioni i SBASHK-ut ka pasur një shkollë të integruar. Drejtoresha dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle kanë shoqëruar



delegacionin e SBASHK-ut nëpër ambientet e kësaj shkolle duke ju treguar se këtu janë 320 nxënës, shumica e të cilëve të kombeve tjera dhe se këtu po bëhej punë e madhe për

integrimin e tyre. Një moment emocional ishte këtu takimi me mësuesin shqiptar Nazmi Rudari. Ai ka përgëzuar sindikatën nga Kosova për angazhimet e pastaj ka shpjeguar për punën që bën ai në këtë shkollë dhe në shkollat tjera me fëmijët shqiptar.



Duke vazhduar me realizimin e agjendës së vizitës studimore delegacioni i SBASHK-ut, i shoqëruar nga z. Fisher është gjendur në ambientet e Akademisë për Trajnimin e Mësimdhënësve. Aty janë pritur nga përgjegjësi i këtij institucioni arsimor, z. Martin Tedzner, i cili ka shpjeguar për gjithë veprimtarinë e kësaj akademie, e cila merret me trajnimet e mësimdhënësve, të cilët këtu paraqiten sipas kërkesave dhe zgjedhjes së tyre për ngritje të vazhdueshme profesionale.



Një takim i veçantë me delegacionin e SBASHK-ut ishte edhe ai me përgjegjësen e GEW për forcimin e rolit të femrës në sindikatë. Lidhur me këto angazhime delegacionin e SBASHK-ut e ka informuar përgjegjësjë në GEW, znj. Sarah Klemann. Në këtë takim është shtruar kërkesa që GEW dhe SBASHK-ut të forcojnë bashkëpunimin dhe të barten përvojat me qëllim të shtimit të vazhdueshëm të rolit të femrës në SBASHK. Delegacioni nga Kosova ishte në këtë përberje : Rrahma Jasharaj, Ymer Ymeri, Vlora Berisha Rexhepi, Naile Uka, Fidan Shaqiri, Vera Ahmeti Sopi dhe Lindita Ukimeraj.



Edhe një takim i SBASHK-ut me Ministrin Kujtim Shala

Angazhim i përbashkët për realizimin e kërkesave të mësimdhënësve

Ministri në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala vazhdimisht ka bërë angazhime për të gjetur mundësi në realizimin e kërkesave legjitime të SBASHK-ut.. Kujtojmë angazhimin e tij që bashkë me



Në të gjitha takimet dhe gjatë gjithë vizitave në institucionet arsimore në këto dy lande të Gjermanisë është biseduar edhe për cilësinë dhe ngritjen e vazhdueshme të saj. Është thënë në të gjitha këto takime se punën e mësimdhënësve në shkollat gjermane e përcjell dhe e mbështet drejtori . Ngritja e vazhdueshme profesionale sipas kërkesave të mësimdhënësve bëhet në Akademinë për Trajnime, por as edhe një herë nuk është menduar e as nuk do të mendohet për ndonjë vlerësim përmes testeve të caktuara . Dijen e mësimdhënësve e kanë vlerësuar profesorët në fakultetet, neve na mbetet t'i mbështesim ata për arritje edhe më të mëdha në punën arsimore e edukative me nxënës, është thënë sa e sa herë nga mikpritësit e delegacionit të SBASHK-ut gjatë vizitës në Gjermani.



Ministrat Abrashi e Bajrami të gjejnë zgjidhje për problemin e mësimdhënësve që nuk gëzojnë pensionin e plotë e që lidhej me çështjen e numërimit të viteve e 90-ta për t'u plotësuar kriteri i Ligjit për pensione që kërkon që personi të ketë së paku 15 vite përvojë të punës. Angazhimi i Ministrit Shala doli të jetë i suksesshëm dhe kjo problematikë është zgjidhur pozitivisht.

Ministri Kujtim Shala ka vazhduar angazhimet dhe takimet me përfaqësues të SBASHK-ut gjithmonë duke dhënë kontribut në qartësimin e çështjeve dhe në gjetjen e zgjidhjeve përmes dialogut. Në frymën e këtij

angazhimi Ministri Kujtim Shala është takuar me kryetarin e SBASHK-ut , Rrahman Jasharaj dhe me përgjegjësin për financa, administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm , Ymer Ymeri. Në këtë takim është diskutuar për kërkesën e SBASHK-ut lidhur me fatin e Ligjit mbi statutin e mësimdhënësve shqiptar të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/1999. Ministri Shala ka kërkuar mirëkuptim nga SBASHK-u dhe është shprehur se do të angazhohet që çështja të zgjidhet në mënyrën më të mirë të mundshme përmes dialogut që do të zhvillohet në takimet e SBASHK-ut me përfaqësuesit më të lartë të Qeverisë së Kosovës. Po ashtu edhe Ministri Bajrami ka shtuar angazhimet dhe ka shprehur gatishmërinë që të organizohen takime me përfaqësuesit më të lartë të

Qeverisë së Kosovës në mënyrë që të arrihet deri të zgjidhje e kësaj kërkesë të SBASHK-ut. Të kujtojmë se kryetari i SBASHK-ut dhe përgjegjësi për financa, administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm , Ymer Ymeri në përpjekje për të marrë përkrahjen për dërgimin në Parlament dhe votimin e këtij ligji janë takuar edhe me shefat e Grupeve Parlamentare të PDK-së dhe LDK-së, por edhe me deputetin z. Zemaj, me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim,z. Hasani dhe me zyrtarë të tjerë. Shpresojmë se gjithë ky angazhim i SBASHK-ut do të jep rezultate dhe me ndihmën e gjithë njerëzve të vullnetit të mirë Ligji do të procedohet drejt Parlamentit.

Delegacioni i SBASHK-ut u takua me Rektorin e Universitetit “Isa Boletini”

Gatishmëri e përbashkët për bashkëpunim

SBASHK-u në kuadër të aktiviteteve të përditshme po vazhdon me vizitat nëpër komunat e Kosovës. Delegacioni i SBASHK-ut i përberë nga: kryetari Rrahman Jasharaj, menaxheri për financa dhe administratë Ymer Ymeri , juristi Blendor Shatri, si dhe përfaqësuesi i Sindikatës në Universitetin e Mitrovicës Afrim Qelaj, kanë vizituar Universitetin e Mitrovicës „Isa Boletini”.

Ata i ka pritur rektori i këtij Universiteti



Prof.Assoc.Dr. Alush Musaj bashkë me prorektorët: Rifat Morina, Ali Sadiku dhe Izet Zeqiri.

Rektori i këtij Universiteti Prof.Assoc.Dr. Alush Musaj ka falënderuar delegacionin e SBASHK-ut për vizitën, e pastaj ka bërë një përshkrim të rrugëtimit të

vështirë të Universitetit „Isa Boletini”, ai ka thënë se fatin e Mitrovicës dhe popullit të saj e ndau edhe universiteti ynë . Rektori Musaj , ka treguar pastaj se në këtë universitet janë 3500 studentë të profileve teknike por edhe atyre shoqërore, ai është shprehur i lumtur se falë angazhimit të madh të Qeverisë së Kosovës, brengat e mëdha të këtij institucioni do t'i takojnë të kaluarës, sepse Kosova bëri investime të mëdha dhe është duke ngritur një Kampus Universitar që do t'ia kenë lakmi edhe vendet e Ballkanit e më gjerë, është shprehur me krenari rektori Musaj.

"I nderuari rektor, SBASHK-un do ta keni partner të sigurt në angazhimet e përbashkëta dhe në takimet që do të keni me kryetarin e sindikatës të universitetit tuaj, z. Afrim Qelaj , bashkërisht do të gjeni zgjidhje për problemet eventuale ", ka deklaruar në këtë takim kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili ka shprehur kënaqësinë edhe në këtë institucion të lartë arsimor ka organizim sindikal të SBASHK-ut. Të dy palët janë shprehur të gatshme për bashkëpunim të sinqertë në shërbim të arritjeve edhe me të mëdha dhe te koordinimit të aktiviteteve të ndryshme .

Është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues

Janë debatuar çështje me rëndësi

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka mbajtur takimin e radhës për të debatuar e marrë vendime lidhur me çështje të rëndësishme. Në fillim të takimit kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM të Komunave të Kosovës kanë raportuar lidhur me deklarin e mësimdhënësve përkitazi me paralajmërimin e MASHT-it për organizimin e testit me shkrim për të punësuarit në Arsimin Parauniversitar. Nga raportet dhe listat me nënshkrime të mësimdhënësve lidhur me këtë çështje është parë se 99 % e mësimdhënësve të Kosovës janë deklaruar kundër organizimit të testit me shkrim për ta. Takimi ishte i hapur dhe atë e kanë përcjellë me vëmendje mediet e shkruara e elektronike. Ishte vendim unanim i Këshillit Drejtues se nuk do të shkohet në test me shkrim.



Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj bashkë me përgjegjësin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë informuar Këshillin Drejtues lidhur me kërkesat e SBASHK-ut drejtuar MASHT-it dhe lidhur me rrjedhën e takimit të tyre me Ministrin Bajrami dhe kabinetin e tij.



Do theksuar se Ministri Bajrami i është përgjigjur me shkrim letrës së SBASHK-ut lidhur me kërkesën për adresimin e çështjeve aktuale në përpjekje për të zgjidhur ato. Lidhur me kërkesën për realizimin e plotë të Kontratës Kolektive Ministri Bajrami ka deklaruar se kjo është përgjegjësi e qeverive lokale dhe se ai për këtë edhe ka mbajtur takime me kryetarët e komunave dhe me drejtorët e DKA-ve. Lidhur me tri pagat me rastin e pensionimit, Ministri Bajrami ka thënë në letrën e tij se do të angazhohet me Qeverinë qendrore për të ndihmuar në realizimin e kësaj kërke.



Ministri Bajrami është përgjigjur në letrën e tij drejtuar SBASHK-ut edhe lidhur me çështjen e unifikimit të pagës me pjesën stimuluese për punëtorët e administratës në UP duke siguruar se do të angazhohet në zgjidhjen e kësaj kërke, edhe pse, si thotë Ministri, kjo çështje është në kompetencë të organeve të UP-së.



Lidhur me kërkesën e SBASHK-ut për Ligjin për statutin e mësimdhënësve shqiptarë për vitet 90/99 Ministri Bajrami ka shprehur gatishmërinë për angazhim të përbashkët që në takime me përfaqësues të Qeverisë të iniciohet çështja dhe që Ligji të shkojë në Parlament për t'u aprovuar.